

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-7

A 37



DRUERO AGUILLER POEMES A RIKES



8347

A37 BIBLIOTEKA ERINISË

DRITËRO AGOLLI

PLESHTI

(poemë satirike)



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

1.

Pleshti me xixëllojën ra në dashuri,
Pleshti xhuxh dhe i zi.

Dhe filloi akoma të ligej,

Dhe filloi akoma të nxihej.

I ati e shihte e bëhej vrer:

– Pse djalit shëndeti s'i merr?



2.

Një natë i tha ngadalë në vesh:

– Ç'të dhemb, o djali im plesht?

Nuk fliste pleshti-bir

Nga xhami bënte sehir . . .

Bënte sehir xixëllojën e bukur,

Mërzia në gjoks i ish futur . . .

I ati pranë – në bisht,

I biri pranë – në bisht,

Hiç!

– Oi, më lojti menç djali,

Po tretet së gjalli!

Folë një fjalë, o bir,


Eh, vuan e bën sehir!

Ai hiç,

Në bisht!

– Ç'ke, o biri im plesht,

Pse hesht?



3.

Dhe biri – plesht me sy nga xhami tha:

– Baba, o baba!

– T'u bëftë babai, o biri im plesht,

Thucja babait në vesh!

– Baba, o baba,

Pa shih atje la!

Pleshti – baba e kuptoi menjëherë

Dhe hop në derë.

– A, ti dashke xixëllojën,

Ta sjell sa të hapësh gojën!



4.

Dhe pleshti - baba shkoi në tridhjetë shtëpi:
– Im bir ka rënë me xixëllojën në dashuri,
Të mblidhemi të bëjmë kuvend,
Im bir për nuse po mbetet pa mend!



5.

Dhe dolën nga vrima e postiqe e tesha
Treqind pleshta e pleshtesha
Dhe thanë:

– Oi, o më i miri i pleshtave,
Do shkojmë ta gjejmë nusen vreshtave.
Ne, mblesët - pleshta, s'të lëmë të vuash,
Mjaft që nuse të duash.

Ku gjen ajo një djalë si ti topolak,
Që hidhet hop në prak;

Ku gjen ajo një burrë aq namusqar,
Akrobat, kërcimtar!

Ku gjen ajo një burrë që di kaq valle,
Që ka fituar në tri festivale,
Që ka marrë

Tri herë çmimin e parë! ..

Dhe u nisën në vreshta
Treqind mblesë – pleshta!



6.

Hopa,
Hopa,
Në driza, në shqopa!
Hopa,
Hopa,
Në brazda, në gropa,
Në sheshe, në vreshta
Treqind mblesë – pleshta!
Merrja këngës, plesht,
Mos hesht!
Të hapet kënga pleshtore
Në lugje, bregore:
«Ne jemi pleshta,
Ne s'kemi eshtra;
Përpara!
Ne – elastikë,
Ne s'kemi frikë,
Përpara!
Për kërcimtarin,
Nusen ta marrim,



Përpara!
Një xixëllojë
Gosti do shtrojë,
Përpara!
Ne jemi mblesë,
Ta shohim nesër,
Përpara!
Një xixëllojë
Do bëhet zonjë,
Përpara!»

7.

Dhe u takuan me treqind xixo e xixëlloja.
Plesht, thoja!

Dhe tha më i vjetri nga pleshtat:


– E dini pse erdhëm në vreshtat?

Ne duam të bëjmë krushqaj,

Më i miri i pleshtave ka rënë në dashuri,

Ka rënë në dashuri e nuk ha e nuk pi,

Ka rënë në dashuri me çupën tuaj




E hop vuaj!
Ai është më i miri i pleshtave,
Ai është armik i gënjeshtreve.
Na thanë se çupa juaj është e ndershme.
Dhe ruan ca zakone të hershme;
Ne djalin e kemi xhevahir
Dhe shumë nikoqir,
Dhe di kaq valle,
Dhe ka fituar në tri festivale,
Dhe ka marrë
Tri herë çmimin e parë.
E dimë se çupa juaj e rritur në bregore
Do të jetë e denjë për vatrën pleshtore,
Do jetë më ngrohtë në postiqe se sa në
vreshta,
Gëzim do ketë se ne jemi pleshta
Dhe hidhemi hop
Bromp.
S'më bie të mburrem se jam modest,
Po ju e dini se ç'domethënë plesht.

... Kështu tha më i vjetri i pleshtave
Dhe hop kërcyen treqind pleshta vreshtave
Dhe përr-përr-përr fletët
Në vreshtët ...

8.

Treqind xixa e xixëlloja dëgjonin
Dhe treqind mblesët-pleshta përgjonin.
Atëhere u ngrit e tha më i vjetri xixo në
vreshta:

– Falemi nderit, o pleshta!



Besoj se djalin e keni topolak,
Por pi gjak!
Më mirë ju pyesni nusen se ç'thotë,
Se fjala ime do jetë e kotë.
Ne s'japim e s'marrim me mblesëri,
Ne japim e marrim me dashuri! . .
Më i vjetri xixo thirri nusen e tha:
– Më i miri i pleshtave me ty ka shtënë
sevda,
Dhe treqind mblesët-pleshta mbajtën vesh
xixëllojën:
– Plesht? S'dua t'ja shoh bojën!
Unë kam xixon tim
Në fluturim!
Unë xixon tim e dua,
Dhe një plesht s'i vjen gjer në thua!
More vesht,
Plesht?

9.

Treqind mblesët - pleshta me treqind xixot
bën fjalë:

– Na falni, po qenki imoralë;

Ju s'paski zakone me kripë,

Se s'paski cipë!

Dhe ikën mblesët - pleshta

Nga vreshta

Hopa,

Hopa,

Në driza, në shqopa,

Hopa,

Hopa,

Në brazda, në gropa!

Dhe këngë s'këndonin, po shanin

Dhe nganin,


hopa,

Hopa,

Në sheshe,


Në vreshta

Treqind mblesë-pleshta!



10.

Dhe erdhë te dhëndrri tym,
Të zinj, si gjym.
Të treqindët u shtruan në postiqe,
I thanë të parit: hiqe!
Hiqe llafin nga goja,
Ç'na tha xixëlloja!
Dhe tha i pari:
— Oi, o më i miri i pleshtave,



17

2006

Mos u marto me atë që bredh vreshtave,
Ajo njëzet burra ka ndarë,
Ajo njëzet burra ka marrë,
Ajo farmak e ka gojën,
Dhe thà: «pleshtit s'ja shoh dot bojën!»
Kur dëgjoi pleshti - baba u nxeh:

– Deh!

Një zuskë që bredh vreshtave
Të shajë sojin e pleshtave?
Kur dëgjoi pleshti – bir:

– Firr!

Baba-plesht,

Mos hesht!

Ta kapim,

Barkun t'ja hapim! –

Tha pleshti – bir

Dhe hop

Në shkop!

– plesht – bir,

Bëj sehir!

Tha pleshti – baba

Dhe hop në tra!

11.

Dhe u nisën të kapnin xixëllojën,

Që s'donte t'ua shihte bojën,

Që shau në vreshta

Treqind mblesë – pleshta!

Plesht – birë,

Plesht – baba,

Nga!

Ndërkohë ra një shkëndijë nga një oxhak

Dhe hop pleshti – bir' topolak.

– Baba – plesht, e kapëm xixëllojën,

Që tha se s'donte të na shihte bojën . . .

Baba – plesht.

Bir – plesht


Hop

Në shesh!

Plesht,

Qesh! . . .

Por ajo s'ish xixëllojë, po shkëndijë oxhaku,



U dogjën pleshtat – biri dhe plaku.
Plesht,
Hesht!
Hop,
Top!